



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.474/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuse, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEȚ e pabazuar ankesa Anr.474/2025, e datës 09.02.2025, parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 09.02.2025, PZAP- i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV në të cilën thekson se "E more Hydajet Hyseni, çka të paska bërë Albin Kurti! Sa i mjerë je dukur sonte në Gjilan. Njerëzit ndoshta ende kanë pak respekt për ty, ju vjen keq për shkak të moshës, e ku ta di unë. Por sonte, mua më je dukur vërtet i mjerë—në fytyrë të shihej mjerimi. Kam të drejtë ta them këtë, sepse je ende gjallë dhe, si i tillë, ke pasur më shumë privilegje nga shteti. Ke pasur më shumë sesa ata që e kanë dhënë jetën për lirinë e Kosovës. Më shumë se ata që pushkën amanet..." Shyqyr që nuk janë ata, e nuk të shohin se si je bërë! E shokët e gjallë që të shohin, le të të vlerësojnë vetë. Edhe mjerimi ka emër, sa bukur i rri pikëpyetja mbrapa!

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik PDK, theksohet se nga shiqimi i postimit të publikuar nga z.Ilir Tahiri, hynë në diskursin e fushatës zgjedhore dhe nuk mund të konsiderohet si përdorim i gjuhës së tillë që nxitë ose provokon, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave të tjera ose pasurinë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11 të LZP-së

Përmes përgjigjes në ankesë ka kërkuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e palës parashtruese dhe të konstatohet se me këto veprime nuk janë shkeljet e rregullave zgjedhore të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregulloret përkatëse

Paneli pasi që shqyrtoj pretendimet ankimore dhe përgjigjen ne ankesë vlerësoi se :

Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerësoi se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim: *përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që nga postimi i cili është publikuar në rrjetin social facebook, ku shihen deklaratat e kandidatit për deputet të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e të cilat deklarata sipas panelit nuk konsiderohen se hyjnë si shkelje konform nenit 34 paragraf 1 nenparagraf 1.11 te LZP.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet ankimore janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, nen 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë
Anr. 474/2025 më datën 11.02.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.